

VENDIM
Nr.1709, datë 29.12.2008

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI NGA MINISTRIA E MBROJTJES
BASHKISË SARANDË TË SIPËRFAQES 10 000 (DHJETË MIJË) M², PJESË E PRONËS
NR.696 “BAZA NDIHMUESE”, SARANDË DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS
SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I
KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5,7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 10 000 (dhjetë mijë) m², pjesë e pronës me numër rendor 696 “Baza ndihmuese”, Sarandë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi bashkisë së Sarandës, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit.

2. Sipërfaqja 10 000 (dhjetë mijë) m², pjesë e pronës me numër rendor 696 “Baza ndihmuese”, Sarandë, sipas genplanit përkatës, të hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Sarandës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe bashkia e Sarandës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha